

AKT THEMELIMI

I shoqërisë tregtare "Solidariteti GM-BH 2022" SH.P.K.

Në Tiranë, sot me dt. 14.04.2022, referuar Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007, ndryshuar me Ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015 si dhe ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, ne Dukagjin Emarllahu, shtetas Kosovar, i biri i Ragim dhe Emine, i datëlindjes 10.01.1964, lindur ne Ferizaj Kosove, pajisur me Pasaportën e shtetit te Kosovës Nr. PO1741296 dhe numër personal 1500696946, njohës shumë i mire i gjuhës shqipe, madhor, me zotësi te plota juridike dhe për te vepruar dhe Hysen Bajrami, shtetas Shqiptar, i biri i Rizait, i datëlindjes 10.04.1967, lindur ne Manez dhe banues ne Tirane, madhor, me zotësi te plota juridike dhe për te vepruar, pajisur me Pasaportën Nr. Bg6855463 dhe Nr. Personal G70410365R me nënshkrimin e këtij akti për themelimin e shoqërisë tregtare "Solidariteti GM-BH 2022" SH.P.K. marrim përsipër të realizoje e të respektoje të drejtat dhe detyrimet me precizitet e mëposhtme:

NENI 1

Krijohet shoqëria me përgjegjësi te kufizuar me emër "Solidariteti GM- BH 2022" sh.p.k, e cila është një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, e te drejtës shqiptare me ortak Shqiptar dhe Kosovar.

Selia e shoqërisë caktohet ne; Lagjja 14, Shkozet - Durrës, Ish ndërmarrja e Serave, Ndërtesa Nr. 1/515/ND; ZK 8515; Volumi 26; faqe 29.

Shoqëria, me vendim te Asamblesë se Ortakeve, mund te vendose te krijoj filiale, dege, zyra, agjenci si dhe përfaqësi, ne bashkëpunim ose jo me shoqëri te vendit ose te huaja, joint venture me persona publike dhe fizike në Shqipëri ose jashtë saj.

NENI 2

Kohëzgjatja e shoqërisë caktohet pa afat te përcaktuar dhe fillon që nga data e regjistrimit të saj në QKR.

Kjo kohëzgjatje mund te ndryshohet me zgjatje te afatit apo shkurtim te tij me vendim te ortakut te vetëm për sa ky është i tillë ose me vendim te Asamblesë se Ortakeve kur numri i ortakëve rritet. Ne këtë raste votimi do te behet me shumice votash te cilën e cakton ligji.

NENI 3

Themeluesit e shoqërisë me këtë akt themelimi, merr përsipër qe te respektoje te gjitha detyrimet qe parashikon legjislacioni tregtar e civil shqiptar për shoqëritë tregtare me përgjegjësi te kufizuar, si dhe ti përmbahet kriterit te respektimit te politikës tregtare qe zhvillohet sot ne Republikën e Shqipërisë.

NENI 4

Kapitali shoqërisë është 10 000 Lekë (dhjete mije leke). I gjithë kapitali zotërohet nga ortakët themelues z. Dukagjin Emarllahu dhe z. Hysen Bajrami.

Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet dhe zotërohet nga ortakët si me poshtë;

Ortaku Dukagjin Emarllahu është zotërues i 1 (një) kuote qe përfaqëson 45% (dyzetë e pese përqindje) te kapitalit themeltarë ose 4500 leke.

Ortaku Hysen Bajrami është zotërues i 1 (një) kuote qe përfaqëson 55% (pesedhjete e pese përqindje) te kapitalit themeltarë ose 5500 leke.

Kapitali i shoqërisë mund te rritet me depozitime te reja te ortakëve te saj, analogjikisht me ciklin e punëve se saj, ose mund te zvogëlohet sipas vendimit te Asamblesë se Ortakeve. Pavarësisht natyrës se kontributit ne rritje te kapitalit themeltar te shoqërisë ne natyrë apo kesh vlera e kuotave themeluese te shoqërisë janë te barasvlershme me njëra tjetrën.

NENI 5

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është i pa përcaktuar dhe përfshin gjithçka që lejohet nga ligji për këtë natyrë shoqërie me përgjegjësi të kufizuar duke përfshirë nder to por pa u kufizuar këtu të tregtimit me shumicë dhe pakicë të hekurit, çimentos, materialeve të ndërtimit, sipërmarrjes së ndërtimit, realizimin e ndërtimit në cilësinë e zhvilluesit apo investitorit të objekteve civile private apo publike, prodhimin dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, naftës dhe nënprodukteve të saj, importe dhe eksporte me qëllim tregtare apo dhe investimi si dhe çdo gjë tjetër që ligji shqiptarë lejon për këtë natyrë shoqërie.

NENI 6

Administrimi i çështjeve të Shoqërisë dhe përfaqësimi i saj i ngarkohet administratorit që është gjithmonë personi fizik i cili zgjidhen ose caktohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve.

Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Si organ ekzekutiv i Shoqërisë, të drejtat dhe detyrat e administratorit, rregullohen me Aktet Themeluese të Shoqërisë, Statutin e Shoqërisë, ligjet përkatëse, si dhe me aktet e tjera normative të nxjerra nga Asambleja e Ortakeve apo dhe me marrëveshje të veçanta.

Administrator të shoqërisë emërohet z. Hysen Bajrami, shtetas Shqiptar, i biri i Rizait, i datëlindjes 10.04.1967, lindur në Manëz dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plota juridike dhe për të vepruar, pajisur me Pasaportën Nr. Bg6855463 dhe Nr. Personal G70410365R që është dhe ortak i saj.

NENI 7

Kjo Kontrate Themelimi hartohet në Tiranë në 5 ekzemplare origjinale, duke pasur secila nga kopjet vlerë të barabartë ligjore e kuptimore.


Ngarkohet Administrator i shoqërisë z. Hysen Bajrami të bëjë depozitimin e akteve pranë QKB dhe regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar.

NENI 8

Ortakët themelues, deklarojnë se njohin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ky Akt-Themelues dhe me vullnet të lirë e firmosin atë në vlerën e kontratës së themelimit të shoqërisë.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQËRISË TREGTARE "Solidariteti GM-BH 2022" SH.P.K

Dukagjin Emarllahu



Hysen Bajrami

